



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 02, datë 26.04.2022

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT TË INFRASTRUKTURËS: “LINJA E TRANSMETIMIT 400 KV SHQIPËRI- MAQEDONI E VERIUT (FIER-ELBASAN-QAFE THANË), LOT 2”, SI DHE NËNSTACIONET: “NËNSTACIONI 400 KV ELBASAN 3 DHE SHTESA 400 KV E NËNSTACIONIT FIER”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË ELBASAN DHE BASHKINË FIER

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST)” sh.a, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit të Infrastrukturës: “Linja e Transmetimit 400 kV Shqipëri- Maqedoni e Veriut (Fier-Elbasan-Qafe Thanë), Lot 2”, si dhe Nënstationet: “Nënstationi 400 kV Elbasan 3 dhe shtesa 400 kV e Nënstationit Fier”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST)” sh.a,
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës përkatëse të taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Elbasan dhe Bashkisë Fier.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

